

VENDIM
Nr. 129, datë 7.3.2018

**PËR PËRCAKTIMIN E ORGANIZATAVE TË PUNËDHËNËSVE DHE TË
PUNËMARRËSVE NË KËSHILLIN KOMBËTAR TË PUNËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 200, të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Organizatat e punëdhënësve dhe të punëmarrësve, anëtarë të Këshillit Kombëtar të Punës, janë si më poshtë vijojnë:

A. Për organizatat e punëdhënësve:

- a) Bashkimi i Bizneseve Shqiptare (BIZNES ALBANIA): 1 anëtar, 1 kandidat;
- b) Shoqata Shqiptare e Bankave (SHSHB): 1 anëtar, 1 kandidat;
- c) Shoqata e Ndërtuesve të Shqipërisë (SHNSH): 1 anëtar, 1 kandidat;
- ç) Shoqata Shqiptare e Turizmit (SHSHT): 1 anëtar, 1 kandidat;
- d) Shoqata e Bizneseve të Ushqim-Pijeve (SHBUP): 1 anëtar, 1 kandidat;
- dh) Shoqata Shqiptare e Teknologjisë së Informacionit (SHSHTI): 1 anëtar, 1 kandidat;
- e) Bashkimi i Investitorëve dhe Industrialistëve Shqiptarë (BI&ISH): 1 anëtar, 1 kandidat;
- ë) Dhoma Kombëtare e Prodhuesve të Veshjeve (DHKPV): 1 anëtar, 1 kandidat;
- f) Byroja Shqiptare e Sigurimeve (BSHS): 1 anëtar, 1 kandidat;
- g) Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar (KASH): 1 anëtar, 1 kandidat.

B. Për organizatat e punëmarrësve:

- a) Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Shqipërisë (BSPSH): 1 anëtar, 1 kandidat;
- b) Aleanca e Sindikatave të Arsimit të Shqipërisë (ASASH): 1 anëtar, 1 kandidat;
- c) Sindikata e Pavarur e Minatorëve të Shqipërisë (SPMSH): 1 anëtar, 1 kandidat;
- ç) Sindikata e Re e Naftëtarëve të Shqipërisë (SRNSH): 1 anëtar, 1 kandidat;
- d) Sindikata Autonome e Ushqimit, Tregtisë, Turizmit (SAUTT): 1 anëtar, 1 kandidat;
- dh) Konfederata e Sindikatave të Shqipërisë (KSSH): 1 anëtar, 1 kandidat;
- e) Federata e Punonjësve të Industrisë së Shqipërisë (FPISH): 1 anëtar, 1 kandidat;
- ë) Federata e Sindikatave të Punonjësve të Shërbimit Shëndetësor (FSPSHSH): 1 anëtar, 1 kandidat;
- f) Federata e Sindikatave të Punonjësve të Artizanatit dhe Manufakturës (FSPAM): 1 anëtar, 1 kandidat;
- g) Federata e Sindikatave të Shërbimeve Financiare, Tregtisë, Bankës e Turizmit: 1 anëtar, 1 kandidat.

2. Emërimi i anëtarëve dhe i kandidatëve të Këshillit Kombëtar të Punës bëhet nga ministri përgjegjës për punën, sipas propozimeve të organizatave të përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi.

3. Vendimi nr. 1060, datë 14.12.2013, i Këshillit të Ministrave, “Për caktimin e numrit të përfaqësuesve të organizatave të punëmarrësve dhe të punëdhënësve në Këshillin Kombëtar të Punës”, shfuqizohet.

4. Ngarkohet Ministria Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama